



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri  
Mbledhja nr. 21  
Prishtinë, më 10. 02. 2009  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**P R O C E S V E R B A L**  
**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri**

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Eqrem Kryeziu, Emrush Xhemajli, Zafir Berisha, Agim Veliu, Bojan Stojanovič, Gani Geci dhe Zulfë Merxha.

Munguan: Melihate Termkolli dhe Ibrahim Selmanaj

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të 10. 12. 2008 dhe 10. 01. 2009,
3. Miratimi i Raportit për vitin 2008 dhe i Planit të punës për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i Projektstrategjisë kundër korrupsionit 2009 -2011,
5. Shqyrtimi i Ligjit për tubimet publike,
6. Shqyrtimi i raporteve nga MPB-ja dhe PK-ja,
7. Shqyrtimi i fushëveprimit të Komisionit,
8. Të ndryshme.

*Kryetari i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve të 10. 12. 2008 dhe 10. 01. 2009**

*Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të 10. 12. 2008 dhe 10. 01. 2009 u miratuan pa vërejtje.*

## **3. Miratimi i Raportit për vitin 2008 dhe i Planit të punës për vitin 2009**

**Kryetari i Komisionit** - Ju keni marrë draftraportin e punës për vitin 2008. Ky është raport teknik, në të cilin janë radhitur - sipas fushave - edhe punët e Komisionit dhe nëse dikush ka ndonjë plotësim për Raportin e punës mund ta paraqesë. Po ashtu kemi edhe draftplanin e punës për vitin 2009. Drafti është përpiluar duke u mbështetur në dinamikën e caktuar sipas agjendës legislative për këtë vit. Ky plan paraqet një skemë, sipas së cilës pritet të zhvillohen aktivitetet për vitin 2009.

*Kryetari komisionit konstatoi se miratohen Raporti i punës për vitin 2008 dhe Plani i punës për vitin 2009.*

## **4. Shqyrtimi i Projektstrategjisë kundër korrupsionit 2009 - 2011**

**Kryetari i Komisionit** - Njoftoi se duke u mbështetur në një përfundim të Kryesisë së Kuvendit të 13 janarit 2009, Komisioni ynë, bashkë me Komisionin për Buxhet dhe me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, janë ngarkuar ta shqyrtojnë Projektstrategjinë kundër korrupsionit dhe Kuvendit t'i paraqesin rekomandime për ta miratuar këtë strategji.

Unë mendoj se kjo strategji ka disa mangësi, sepse nuk përputhet me Ligjin kundër korrupsionit dhe i mungon plani i veprimit. Duhet ta caktojmë një referues për ta shqyrtuar këtë projektstrategji.

**Gani Geci** - Kjo strategji duhet të analizohet me shumë kujdes, sepse shkalla e korrupsionit po shënon rritje. Sidomos duhet të bëhet mbikëqyrja e tenderëve.

**Kryetari i Komisionit** - Konstatoi se deputeti Gani Geci caktohet referues për shqyrtimin e kësaj projektstrategjie. Rekomandimet do t'ia dërgojë Komisionit, ndërsa Komisioni do t'i çojë në seancë.

## **5. Shqyrtimi i Ligjit për tubimet publike**

**Kryetari i Komisionit** - Njoftoi se ky ligj ka qenë njëri nga ligjet e pashpallura nga PSSP-ja. Me vendim të Kuvendit Komisioni ka qenë funksional për ta shqyrtuar këtë ligj. Ligji është miratuar nga Kuvendi, por nuk është shpallur nga presidenti i Kosovës. Ka vërejtje lidhur me nenin 12. Ne duhet t'i shqyrtojmë këto vërejtje dhe të dalim me rekomandimin për seancë plenare. Konstatoi se deputeti Agim Veliu caktohet përgjegjës për t'i shqyrtuar këto vërejtje lidhur me Ligjin për tubimet publike.

## 6. Shqyrtimi i raporteve nga MPB-ja dhe PK-ja

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kryetari i Komisionit njoftoi se ishte kërkesë e Komisionit që Ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i Policisë të paraqesin raporte për situatën e sigurisë në Kosovë para Komisionit. Mbledhjen e fundit nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për të vendosur nëse këto raporte do t'i adresoheshin seancës. Unë po hap debat për këtë çështje.

**Agim Veliu** - Unë kam munguar në mbledhjen e fundit, sepse kemi pasur seancë dhe kam kujtuar se kur ka seancë nuk mbahet mbledhja e Komisionit. Megjithatë do t'i shohim raportet dhe do të vendosim si t'i procedojmë më tutje.

**Bojan Stojanovic** - Ka raste kur veprime të jashtëligjshme ndodhin edhe në rajone të tjera e jo vetëm në veriun e Kosovës. Për shembull kemi rast të një plaçkitjeje në Graçanicë, por policia nuk e ka zbardhur atë .....

**Kryetari i Komisionit** - Konstatoi se raportet nga MPB-ja dhe nga Policia e Kosovës duhet t'u dërgohen edhe një herë anëtarëve të Komisionit dhe pastaj do të vendoset se a do të debatohen në seancë të Kuvendit.

## 7. Shqyrtimi i fushëveprimit të Komisionit

**Kryetari i Komisionit** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se deri më 15 mars do të miratohet Rregullorja e re e Kuvendit dhe Komisioni ynë duhet ta bëjë një korigjim të fushëveprimit aktual. Ne e kemi fushëveprimin aktual, por mendoj se duhet të ridraftohet edhe një herë ky fushëveprim. Prandaj unë propozoj që një anëtar i Komisionit të caktohet përgjegjës dhe bashkë me stafin ta hartojnë një propozim që në mbledhjen tjetër ta miratojmë. A pajtoheni me këtë propozim?

**Eqrem Kryeziu** - Pajtohem me propozimin që një anëtar të caktohet përgjegjës për këtë çështje.

**Kryetari i Komisionit** - Konstatoi se Zafir Berisha u caktua përgjegjës për çështjen lidhur me draftimin e fushëveprimit të Komisionit.

## 8. Të ndryshme

*Për këtë pikë nuk pati diskutime.*

Mbledhja përfundoi në orën 12.30

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa

---

Kryetar i Komisionit